

REGULLORE

“Per Organizimin e Veprimtarise te
Keshillit Bashkiak **DROPULL**”.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI

BASHKIA DROPULL

TEL: 088490059

V E N D I M

Nr 22 date 01/09/2015

“Per Miratimin e Rregullores se Keshillit te Bashkise”


Mbeshtetje Ne ligjit Nr 8652 date 31.07.2000 neni 32 pika a “Per Organizimin dhe Funkionimin e Qeverisjes Vendore” ,

V E N D O S I

*Miratimin e Rregulloren e Brendeshme te Keshillit te Bashkise “Per Organizimin dhe Funkionimin e Keshillit te Bashkise ”.

Kryetari

Panajot LULO



I – Dispozita te pergjithshme

Neni 1

Keshilli Bashkiak organizon dhe realizon veprimtarine e tij ne baze te kushtetutes, Ligjit "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", akteve ligjore, nenligjore, si dhe ne perputhje me kete rregullore.

Per ceshtjet qe nuk jane theksuar ne kete rregullore , Keshilli Bashkiak merr vendime te vecanta .

Keshilli Bashkiak perbehet nga keshilltare te zgjedhur sipas dispozitave te Kodit Zgjedhor.

II – Konstituimi I Keshillit Bashkiak

Neni 2

Keshilli Bashkiak thirret ne mbledhjen e tij te pare nga sekretari I Keshilli Bashkiak dhe ne mungese te tij nga prefekti jo me vone se 30 dite nga shpallja e rezultatit te zgjedhjeve nga K.Q.Z.

Neni 3

Mbledhja e pare e Keshillit Bashkiak eshte e vlefshme kur ne te marrin pjese jo me pak se gjysma e numrit te pergjithshem te anetareve te tij.

Kur nuk sigurohet kjo pjesemarrje, mbledhja thirret 3 dite me vone por jo me shume se tre here. Ne rast se pas tre thirrjeve nuk sigurohet kjo pjesemarrje keshilli konsiderohet I shperndare.

Mbledhja e pare e Keshillit Bashkiak deri ne zgjedhjen e kryetarit te tij drejtohet nga keshilltari me I vjeter ne moshe.

Neni 4

Keshilli zgjedh komisionin e verifikimit te mandateve me tre anetare I cili qendron ne funksion gjate gjithë kohes ne te cilin vazhdon mandati I keshillit.

Dhenia dhe heqja e mandatit behet me shumicen e votave te numrit te pergjithshem te anetareve.

Ankimi kunder vendimit te keshillit per anulimin e mandatit behet ne gjykaten administrative.

Vendimi I gjykates eshte I formes se prere.

Mandati I keshilltarit mbaron para afatit me propozim te komisionit te mandateve:

- Kur ndryshon vendbanimin.
- Kur jep doreheqje.
- Kur krijon kushte te papatujshmerise sipas nenit 25 te ligjit.
- Kur mandati eshte marre ne menyre te parregullit.
- Kur humbet zoterine juridike me vendim gjykate.
- Kur ndahet nga jeta.
- Kur nuk merr pjese ne mbledhje te keshillit per nje periudhe 6-mujore.
- Kur denohet per kryerjen e nje vepre penale me vendim gjykate te formes se prere.

Neni 5

Ne mbledhjen e pare, keshilltaret bekohen para keshillit.

Keshilltari qe refuzon te beje dhe nenshkruar betimin sipas formules nuk I jepet mandati dhe zevendesohet nga keshilltari I radhes se listes shumemerore te te njejtit subjekt elektoral.Ne cdo rast zbatohet barazia gjinore.

Neni 6

Keshilli zgjedh kryetarin dhe z/kryetarin me shumicen absolute te votave.

III – Organizimi I keshillit

A - Kryetari I Keshillit

Neni 7

Kryetari I keshillit bashkiak,dhe ne mungese te tij, zevendesuesi I tij kryejne keto detyra:

- 1.Organizon mbledhjen e keshillit
- 2.Pergatit projektin per mbledhjet e keshillit ne perputhje me planin e miratuar te keshillit duke terhequr mendimin e grupeve te keshilltareve, te kryetarit te bashkise dhe administrates.
- 3.Ndihmon ne veprimtarine e komisioneve te keshillit.
- 4.Ndjek zbatimin e kesaj rregulloreje.
- 5.Perfaqeson keshillin bashkiak.
- 6.Hap, drejton dhe mbyll mbledhjet e keshillit bashkiak.
- 7.Siguron rregullin ne sallin e mbledhjes.
- 8.Verteton dhe firmos protokollin e mbledhjeve te keshillit bashkiak dhe kerkon qe ato te firmosen dhe nga sekretari.
- 10.Shqyrton kerkesat dhe ankesat drejtuar keshillit bashkiak.

Neni 8

Marredheniet e keshillit bashkiak ne bashkite e tjera, brenda dhe jashte vendit organizohen nga kryetari ne perputhje me legjislacionin.Perberja e delegacioneve duhet te jete pluraliste duke patur ne perberje perfaqesues te komisonit perkates te keshillit bashkiak.

Grupet perfaqesuese te miratohen nga keshilli bashkiak.

B – Sekretari I keshillit bashkiak.

Neni 9

Sekretari I keshillit emerohet nga keshilli bashkiak sipas propozimit te kryetarit te keshillit me shumicen e votave te pergjithshme te anetareve.

Sekretari I keshillit bashkiak pergjigjet per:

- 1.Mbajtjen e dokumentave zyrtare te keshillit.
- 2.Ndjekjen e punes per pergatitjen e materialeve te mbledhjes se keshillit sipas rendit te punes.
- 3.Njoftimin per zhvillimin e mbledhjeve te keshillit.
- 4.Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve te nxjerra nga keshilli bashkiak.
- 5.Pergatitjen e seancave keshillmore ne komunitet.

6. Mbikqyrjen e zbatimit të rregullores së keshillit.
7. Informimin e keshillit mbi zbatimin e akteve të nxjerra nga keshilli bashkiak.
8. Kryerjen e çdo funksioni tjetër që do t'i ngarkohet nga keshilli bashkiak.

C – Grupet e keshilltareve

Neni 10

Keshilltaret mund të formojnë grupe në përputhje me perkatesinë partiake ose të orjentimit të tyre politik.

Numri minimal për formimin e një grupi do të jetë jo më pak se 3 keshilltare.

Neni 11

Çdo subjekt paraqet të kryetari I keshillit vendimin për formimin e grupit, listen e anëtarëve dhe drejtuesve të grupit.

Kryetari I keshillit bën shpalljen e krijimit të grupeve dhe drejtuesve të tij.

Grupet e keshilltareve dhe përgjegjësit e tyre shkruhen në një regjister të vecantë nga sekretari I keshillit.

Neni 12

Çdo keshilltar mund të marrë pjesë vetëm në një grup dhe në rast se largohet nga grupi duhet të bëjë kërkesë me shkrim drejtuesve të grupit dhe kryetarit të keshillit.

Neni 13

Grupi I keshilltareve përcakton keshilltaret që do të diskutojnë në emër të grupit. Ky rregull nuk kufizon të drejtën e keshilltareve të tjere të diskutojnë.

D – Komisionet e keshillit

Neni 14

Komisionet janë organe të keshillit. Ato kryejnë funksione për njohjen e gjendjes, për realizimin e iniciativave dhe të kontrollit të keshillit. Komisionet janë të përhershme ose të përkohshme.

Neni 15

Numri, objekti dhe përberja e komisioneve të përhershme bëhet me vendim të vecantë. Keshilli mund të bëjë ndryshime, në llojin, numrin dhe përberjen e komisioneve të përhershme.

Neni 16

Anëtarët e komisioneve zgjidhen nga anëtarët e keshillit me votim të hapur me propozim të Kryetarit të Keshillit pas konsultimit paraprak me kryetarët e grupeve. Kryetarët dhe z/kryetarët e komisioneve zgjidhen nga anëtarët e komisioneve.

4

Neni 17

Cdo keshilltar mund te zgjidhet anetar deri ne dy komisione te perhershme. Kryetari dhe z/kryetari I keshillit nuk marrin pjese ne komisione. Ne punen e komisioneve mund te perfshihen dhe eksperte te jashtem pa te drejte vote.

Neni 18

Drejtuesit e komisioneve pergjigjen per punen e komisionit dhe bashkerendojne punen dhe komisione te tjera.

Neni 19

Komisionet e perhershme pergatisin projekt-vendimet, projekt - urdheresat dhe ia paraqesin keshillit per shqyrtim e miratim.

Komisionet e perhershme studiojne dhe analizojne efektivitetin e akteve ne fuqi (vendimet, urdheresat e rregulloret).

Komisionet e perhershme shqyrtojne raportet, njoftimet dhe relacionet qe do t'i paraqiten Keshillit nga Kryetari I Bashkise, zevendesi I tij dhe drejtuesit e ndermarrjeve e institucioneve ne varesi.

Komisionet e perhershme shqyrtojne edhe njoftime te tjera qe vijne ne Keshill dhe sjellin ne mbledhje propozimet e veta te motivuara.

Komisionet e Keshillit cdo 6 muaj raportojne me shkrim ne Keshillin e Bashkise per punen e bere prej tyre.

Neni 20

Nepunesit e administrates se Bashkise si dhe ato te ndermarrjeve dhe institucione jane te detyruar t'u japin te gjitha te dhenat qe kerkohen nga Komisionet ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjote ne fuqi.

Me kerkesen e tij keshilltari informohet dhe I vihet ne dispozicion ne cdo kohe nga administrata e Bashkise cdo lloj dokumentacioni per njohjen e problemeve te juridiksionit te saj.

Trajtimi dhe kualifikimi I Keshilltareve behet sipas programit vjetor te miratuar nga vete Keshilli I Bashkise.

Neni 21

Komisioni I perkershem, mblidhet prej Kryetarit ose zevendesit te tij, ose me kerkesen te me shume se gjysmes te anetareve te Komisionit.

Keshilltaret, marrin pjese ne komisione edhe kur nuk jane anetare, por pa te drejte vote.

Organi qe ka paraqitur projekte ne Keshill, merr pjese ne Komisione ne kohen e shqyrtimit te tyre, duke caktuar perfaqesuesit e vet, te cilet japin sqarimet e nevojshme.

Mbledhjet e Komisioneve, jane te vlefshme kur marrin pjese me shume se gjysma e anetareve te pranishem, me votim te hapur.

Neni 22

Komisionet e perhershme, mund te organizohen, edhe me mbledhje te perbashketa, dhe drejtohen nga njeri prej kryetareve te komisioneve pjesemarrrese, me mirekuptim.

Ne mbledhje te perbashketa, cdo komision, merr ne menyre te vecante, vendime per ceshtjet e qyrtuara.

Neni 23

Per cdo projekt, akt te vecante, qe shqyrton komisioni, ben raportin e vet, qe ja paraqet Keshillit, ne kohen e shqyrtimit te aktit.

Raportimi para Keshillit behet nga Kryetari ose nje anetar I komisionit qe caktohet nga komisioni me propozim te drejtuesit te tij.

Ne raport paraqiten te gjitha qendrimet e mbajtura per problemin e dhene (mendimi I shumices dhe pakices gjate marrjes se vendimit).

Neni 24

Ne mbledhjet e komisioneve te perhershme, mbahet protokoll, I cili firmoset nga Kryetari I Komisionit.

Neni 25

Komisione te perkohshme, formohen per nje problem konkret, per studimin apo pergatitjen e nje projekt - vendimi te caktuar. Menyrat e krijimit te komisioneve te perkohshme, jane te njellojta me ato te komisioneve te perhershme.

IV – Mbledhja e Keshillit

Neni 26

Keshilli I Bashkise thirret ne mbledhjen e tij te zakonshme nga:

- Kryetari I Keshillit te Bashkise.

Mbledhja e zakonshme, thirret jo me pak se nje here ne muaj.

Thirrja e Keshillit behet se paku 5 dite para dates se mbledhjes se zakonshme.

Thirrja behet me shkrim, dhe ju dergohet keshilltareve.

Ne thirrje shenohet rendi I dites, data, ora dhe vendi I mbledhjes.

Njoftimi I keshilltareve behet, me ane te mjeteve te ndryshme te informimit publik, me telefon., me poste ose dorazi.

Keshilli mblidhet jashte radhe nga vete Kryetari I Keshillit ose kur atij I kerkohet me shkrim nga:

- Kryetari I Bashkise
- Prefekti per ceshtje qe lidhen me ushtrimin e funksioneve te tij.
- 1/3 e anetareve te Keshillit.

Njoftimi I keshilltareve duhet te behet 48 ore para fillimit te mbledhjes me telefon ose gojarisht.

Keshilli mund te mblidhet per ceshtje emergjente.

Keshilltaret duhet te njoftohen deri 1 ore para fillimit te mbledhjes me telefon.

Neni 27

Mbledhjet e Keshillit, jane te hapura per publikun. Cdo qytetar lejohet te ndjeke mbledhjet e Keshillit. Vete Keshilli mund te vendose, me shumicen e votave te numrit te pergjithshem te anetareve, qe nje mbledhje ose ceshtje te vecanta te saj t'i beje te mbyllura.

Problemet e buxhetit, diskutohen kurdohere ne mbledhje te hapura.

Propozime per mbledhje te mbyllura, behet nga Kryetari I Keshillit si dhe nga cdo keshilltar, duke percaktuar problemin dhe arsyetimin per kete propozim.

Pjesemarresit nga publiku, te ftuarit ne kohen e mbledhjes, qendrojne ne vende te caktuara per ta dhe jane te detyruar te respektojne rregullat e mbledhjes ne cdo rast.

Drejtuesi I mbledhjes vendos rregull dhe qetesi dhe sipas rastit urdheron qe persona te vecante, qe pengojne zhvillimin e mbledhjes te nxirren jashte.

Neni 28

Kryetari I Keshillit, hap mbledhjen kur eshte siguruar shumica e anetareve te Keshillit me perjashtim te rasteve kur kerkohet nje shumice tjeter (e cilesuar) per marrjen e vendimeve, sipas ligjit.

Kryetari pezullon mbledhjen, nese gjate saj konstatohet se nuk sigurohet shumica e keshilltareve te mjaftueshem per vendimmarrje).

Neni 29

Keshilli I Bashkise, para shqyrtimit dhe miratimit te akteve, duhet te zhvilloje seanca keshillimi me komunitetin.

Per rastet e parashikuara ne piken 32 skronha "dh", "e", "f", dhe "k" te ligjit per Qeverisjen

Vendore.

Menyra e keshillimit jane:

- Takime te hapura me banoret.
- Takime me grupe specialistesh te fushave perkatese.
- Takime me institucione dhe organizata jo qeveritare.
- Organizimin e referendumeve vendore.

V – Informimi I publikut

Neni 30

Sekretari I Keshillit eshte pergjegjes, per shpalljen dhe informimin e publikut, per aktet e nxjerra nga Keshilli I Bashkise.

Afishimi I akteve, te behet ne stendat e vendosura ne hyrje te Bashkise.

Publikimi I akteve mund te behet edhe ne Mediat lokale (te shkruara dhe elektronike).

Aktet qe kane rendesi per publikun te redaktohen dhe te publikohen dhe ne gjuhen amtare.

Neni 31

Keshilli miraton nje program "Vjetor" te mbledhjeve e te ceshtjeve qe do te shqyrtoje, ne bashkeveprim me aparatat e Bashkise, ndermarrjet e institucionet qe kryejne veprimtari ne territorin e tij.

Ne fillim te cdo mbledhjeje miratohet rendi I dites, I percaktuar ne thirrjen e Keshillit. Propozimet per t'u perfshire ne rendin e dites probleme te motivuara mund te behen edhe ne fillim te mbledhjes.

7

Keshilli shqyrton vetem probleme qe perfshihen ne rendin e dites se mbledhjes.
Ne fund te mbledhjes miratohet rendi I dites per mbledhjen e ardhshme I cili u behet I njohur personave te ngarkuar per pergatitjen e materialeve.

Neni 32

Kryetari drejton mbledhjen, dhe I jep fjalen diskutanteve.
Kryetari nuk drejton mbledhjen, vetem ne raste kur ai merr pjese direkt ne debat.
Asnje keshilltar, nuk mund te diskutoje pa ju dhene fjala nga Kryetari.
Kryetari harton listen me emrat e personave, qe kane bere kerkese per diskutimin, dhe percakton rradhen e diskutimeve ne perputhje me kohen e berjes se kerkeses.

Neni 33

Per ceshtje proceduriale, fjala jepet menjehere.
Ceshtje proceduriale jane ato qe kane te bejne me propozime per ndryshime, apo plotesime, ne rregullin e zhvillimit te mbledhjes.
Ceshtjet proceduriale, paraqiten qarte e shkurt pa hyre ne thelbin e problemeve ne shqyrtim.

Neni 34

Keshilltaret flasin nga vendi.
Nese diskutanti shmanget nga tema, Kryetari I paralajmeron, dhe nese shkelja vazhdon, atij I hiqet e drejta e fjales, per ate problem te rendit te dites.
Keshilltari mund te diskutoje, vetem nje here, per problemin qe shqyrtohet.
Kohezgjatja e diskutimit do te jete per kryetarin e grupit 5 minuta dhe per keshilltarin 3 minuta. Kur kerkohet nje kohezgjatje ndryshe per diskutime, Keshilli vendos kohen e zgjatjes se diskutimeve ne pergjithesi apo probleme te vecanta qe ne fillim te mbledhjes.
Ne raste kur, diskutanti tejkalon kohen e percaktuar, paralajmerohet per te perfunduar, nese vazhdon, I hiqet e drejta e fjales.
Keshilltari nuk mban pergjegjesi per mendimet e dhena gjate zhvillimit te mbledhjes.
Keshilltari sipas rastit dhe deshires mund te diskutoje ne gjuhen zyrtare dhe ne ate amtare.

Neni 35

Keshilltari ka te drejten e replikes.
Replika, eshte nje qendrim I paraqitur, ne menyre te shkurter, per permbajtjen e nje diskutimi, dhe nuk mund te vazhdoje, me shume se nje minute. Per te njejtin diskutim, mund te behen deri ne dy replika.
Pas paraqitjes se replikave keshilltari qe ka diskutuar ka te drejten e pergjigjes, me nje afat 2 minuta.

Neni 36

Kryetari dhe Z/Kryetari I Bashkise mund te marrin fjalen per diskutim sa here qe e kerkojne, por vetem njeri prej tyre per problemin qe diskutohet.
Te njejtin te drejte, e kane dhe drejtuesit apo keshilltaret e caktuar, ne emer te grupit te keshilltareve.

8

Neni 37

Nese lista emerore e diskutimeve, ka perfunduar, dhe asnje keshilltar nuk kerkon te diskutoje, Kryetari shpall mbylljen e debatit.

Ne rastet kur paraqitet nga keshilltare kerkesa per nderprerjen e debatit, apo per te shtyre debatin perpara votimit fjala I jepet nje Keshilltari qe nuk eshte dakort me propozimin e bere.

Propozimi per nderpritjen e debatit hidhet ne vote perpara propozimit, per shtyrjen e debatit. Nese pranohet propozimi per nderprerjen e debatit, por pa kryetare grupesh, qe nuk kane diskutuar per problemin ne debat, I jepet fjala njerit nga keshilltaret per cdo grup.

Neni 38

Ne rastet kur krijohet zhurme ose prishet rregulli ne mbledhjen e Keshillit e pengohet ecuria normale e punes se tij, Kryetari mund te nderprese mbledhjen per 30 minuta dhe vetem njehere.

Mbledhja mund te shtyhet me vendim te Keshillit me propozim te Kryetarit ose grup keshilltaresh.

Neni 39

Ne mbledhjen e Keshillit mbahet proces verbal nga Sekretari I Keshillit ose nga nje punonjes I caktuar per kete qellim.

Ne fund proces verbali firmoset nga Kryetari, Nen Kryetari I Keshillit, kur drejton mbledhjen si dhe dy Keshilltare, nje pozita nje opozita sekretari.

Kur caktohet nje punonjes tjeter per te mbajtur proces verbalin detyrimisht dhe ai duhet te firmosi ne fund. Proces verbali mund te mbahet dhe me stenografi si dhe me mjete incizimi.

Ne keto raste hidhet pastaj me shkrim ne leter dhe firmoset sic u tha ne paragrafin e mesiperem. Shiritat e manjetofonit ne keto raste ruhen per I vit.

Neni 40

Te gjitha aktet qe miraton Keshilli I Bashkise shpallen brenda 10 diteve nga data e miratimit te tyre dhe hyjne ne fuqi 10 dite pas shpalljes. Ne rastet kur jane bere gabime ne hedhjen e akteve te Keshillit, korigjimi e tyre behet me urdher te Kryetarit te Keshillit mbasi degjohet paraprakisht, titullari qe ka paraqitur aktin dhe referuesi nga Komisioni perkates I Keshillit.

Aktet me karakter individual hyjne ne fuqi ne daten e njoftimit te tyre subjekteve qe perfshihen ne to ose personave.

"Pas kthimit te akteve nga Prefekti I Qarkut ne dosjen e Keshilltareve te depozitohet nga nje kopje e aktit te miratuar".

V - Votimi

Neni 41

Votimi eshte individual. Votohet me fjalet "PO", "KUNDER", "ABSTENOJ". Votimi kryhet hapur ose I fshehte sipas ceshtjeve. Aktet me karakter individual miratohen kurdohere me votim te fshehte.

Votimi I hapur kryhet nepermjet ngritjes se dores ne votim te pergjithshem ose me votim nominal emer per emer.

Ne votimin nominal, njeri nga anetaret e komisionit lexon emer per emer keshilltaret dhe secili keshilltar me te degjuar emrin pergjigjet si me lart "PO" etj.

Votimi I fshehte kryhet me flete votimi, te cilat hartohen drejtperdrejt ne Keshill.

Per organizimin e votimit formohet nje komision I vecante per zhvillimin dhe shpalljen e rezultateve te votimit si rregull me perfaqesues nga grupe te ndryshme keshilltaresh.

Fletet e votimit dhe proces verbali I votimit ruhen ne dosjen e mbledhjeve te keshillit. Cdo keshilltar ka te drejten e propozimit per percaktimin e menyres se votimit.

Propozimi hidhet ne vote pa debat.

Neni 42

Kryetari shpall procesin e votimit. Gjate procesit te votimit nuk I jepet fjala asnje keshilltari per diskutim.

Sipas nevojës, drejtuesit e grupeve mund te kerkojne para fillimit te votimit te terhiqet grupi per diskutim per nje afat deri ne 5 minuta, mbas kesaj fillohet votimi.

Ne fillim behet votimi ne parim per aktin qe votohet. Pas kesaj behet votimi per cdo propozim te bere sipas radhes se paraqitjes se tyre.

Ne rastet kur kerkohet dhe vendos Keshilli, votimi behet vecas per cdo pike te projektit te paraqitur. Ne keto raste ne fillim hidhet ne vote propozimi per heqjen fare te pikes (kur ka propozime te tilla) dhe pastaj votohet per ndryshimet e plotesimit e tij.

Ne rastet kur nuk votohet "PRO" me shumicen e votave, propozimi quhet qe nuk miratohet dhe hiqet nga votimi tjeter.

VI – Procedura e paraqitjes se projekteve ne keshill

Neni 43

Kryetari I Bashkise, Z/Kryetari dhe komisionet e perhershme, paraqesin ne keshill projekt-vendimet dhe projekt-urdheresat.

Projektet se bashku me relacionet perkatese, ku jepen sqarime per motive perse propozohen akti, dhe per menyren e zgjidhjes se ceshtjeve te vecanta, I drejtohen Kryetarit te Keshillit.

Pranimi I tyre nga Sekretari I Keshillit do te behet kur ato jane te sigluara nga Kryetari I Bashkise, Z/Kryetari, Pergjegjesi I Sektorit perkates dhe juristi.

Neni 44

Kryetari I Keshillit, nepermjet Sekretarit, u shperndan projektet Komisioneve te Perhershme, ne perputhje me karakterin e perkatesise se tyre, duke percaktuar cili komision do te jete "Kryesor", organizon e koordinon shqyrtimin e projektit, ruajtjen e afateve dhe pergatit raportin, per mbledhjen e Keshillit.

Komisionet e interesuara, gjithashtu japin mendime per projektet e marra dhe ja drejtojne ato Kryetarit nepermjet sekretarit perpara dites se shqyrtimit te projektit ne Keshill.

Komisionet e perhershme, ne raportet qe paraqesin deklarohen per domosdoshmerine e atit, dobine e tyre, mundesite financiare per plotesimin e tyre.

Ato bejne propozime te argumentuara para Keshillit, per te pranuar projektin apo duke I bere ndryshime, plotesime apo per te mos u pranuar.

Kur paraqitesi I prokektit, nuk eshte dakort me raportin e Komisionit, ai mund te paraqese ne Keshill, nje raport plotesues.

Neni 45

Projekt-vendimet e projekt-urdheresat shqyrtohen ne Keshill pas raportimeve qe bejne paraqitesit e tyre dhe komisionet perkatese. Ne raste te kunderta kur nuk merr pjese ne mbledhje paraqitesi I materialit, Keshilli vendos nese do te shqyrtohet materiali ne ate mbledhje apo do te shtyhet per nje mbledhje pasardhese.

Neni 46

Kur Keshilli I sheh te arsyeshme merr vendimin per rishqyrtim te projektit pasi plotesohet me tej ai. Ne kete rast, ai cakton kohen e rishqyrtimit, e ne rastet me te rregullta e parashikon per ne rendin e dites te mbledhjes se ardhshme.

Ne kere rast, per plotesimet qe do te behen ndiqet e njejta rruge si me projektin fillestar.

Projekti fillestar nuk I jepet paraqitesit me perjashtim te rastit kur bie dakort vete Keshilli, me te drejten qe dhe raporti I pare t'i rikthehet Keshillit.

VII - Raportet e Keshillit me Kryetarin

Neni 47

Keshilltaret ne mbledhjen e Keshillit, mund t'i drejtojne Kryetarit apo zevendesit te tij pyetje. Pyetjet duhet te jene te qarta, konkrete, dhe te kerkojne informatat e domosdoshme per sqarimin e problemeve, qe shqyrtohen sipas rendit te dites.

Kur problemet qe behet pyetja, nevojitet kohe per nxjerrjen e te dhenave sqaruese, pyetjet behen jo me vone se nje dite para. Ne keto raste pyetjet te drejtohen me shkrim. Kryetari ka te drejte te kerkoje kohen e duhur per pergatitjen e te dhenave.

Ne keto raste, ne mbledhje te Keshillit, futet ne rend te dites dhenia e pergjigjeve nga Kryetari me shkrim ose me goje.

Ne rastet kur mungon Keshilltari, qe ka bere pyetjen paraprakisht, atehere Kryetari nuk jep pergjigje duke e shtyre per mbledhjen pasardhese.

Autori I pyetjeve mund te terheqe pyetjet e bera me pare duke u deklaruar ne mbledhje ose duke e paraqitur terheqjen me shkrim.

Kur fillohet nga pergjigja e pyetjeve Keshilltari qe pyet mund te kerkoje paraprakisht te sqaroje ndonje ceshtje qe lidhet me shkaqet perse ka lindur pyetja.

Neni 48

Kryetari dhe zevendesit I tij te cilit I eshte bere pyetja jep pergjigjen me goje ose me shkrim. Ne rastet kur ai nuk eshte ne gjendje te pergjigjet jep sqarimet e nevojshme per kete.

Pas perfundimit te pergjigjeve Keshilltari qe ka bere pyetjen ka te drejte te beje pyetje plotesuese per sqarimin e problemeve.

11

Gjate pergjigjes se pyetjeve nuk lejohet te behet debat.
Pas pergjigjes se pyetjeve Keshilltari ka te drejten e replikes duke dhene konsideraten e tij per pergjigjen e dhene.

Neni 49

Kryetari I Bashkise merr pjese ne mbledhjet e Keshillit.

VIII - Marredheniet e Keshillit me Komunitetin

Neni 50

Ne mbledhjet e Keshillit te Bashkise si pike e vecante e rendit te dites mund te trajtohen:

- a- Kerkesat , ankesat,letrat, petitionet, drejtuar Keshillit te Bashkise.
- b- Kerkesat, ankesat me goje qe kane dale gjate pritjes dhe takimeve te keshilltareve me komunitetin.
- c- Kerkesat si rregull do te shoqerohen me mendimin dhe propozimin e zyres perkatese te administrates se Bashkise.

SHUMEFISHIMI I MATERIALEVE

Neni 51

Raportet dhe relacionet e Keshillit do te shumefishohen per cdo keshilltar dhe dergohen atyre para dates se mbledhjes.

Aktet redaktohen dhe botohen dhe ne gjuhen greke.

MIRATUAR NE MBLEDHJEN E KESHILLIT TE BASHKISE DATE 01/09/2015

**PER KESHILLIN E BASHKISE
KRYETAR**

PANAJOTI LULO

